

Syllabusi i lëndës

Lënda: Sociologji
Programi i studimit: Studime Islame
Numri i ECTS kredive: 4
Statusi i lëndës: Zgjedhore
Kodi i lëndës: 311
Fondi i orëve: 2+2
Viti akademik: 2015/2016
Semestri: -VI-të
Mësimdhënësi: Prof. Besnik Fetahu, PhD candidate
Mobil: 044/220-484, e-mail: besnik.fetahu@gmail.com

PËRSHKRIMI I SHKURTËR I LËNÐËS	Ky kurs ofron një hyrje për problemet, çështjet, temat dhe idetë kryesore të Sociologjisë. Ajo ka për qëllim të përcjellë faktet themelore sociale në shoqëri duke u mundësuar studentëve që të miratojnë një qasje shkencore për kuptimin dhe interpretimin e fenomeneve sociale dhe të zhvillojnë imagjinatën e tyre sociologjike mbi problemet e natyrës sociale, ekonomike dhe politike.		
QËLLIMI	Qëllimi i kursit është t'i japë studentit një pasqyrë të qartë të strukturave sociale, metodat e studimit të shoqërisë, dilemat teorike, disa praktika të rëndësishme të komunikimit dhe ndikimit të medias. Të menduarit sociologjikisht është gjithmonë kurioze rreth asaj përse njerëzit sillen në mënyra që ata sillen zakonisht? Andaj, ky kurs trajton më në thellësi sjelljet sociale të individit duke ofruar gjithmonë një shpjegim kritik dhe analitik mbi çështjet e shumta që hasim në shoqëri.		
PROGRAMI	Javët	Tema	Literatura
	Java – I	C'është Sociologjia? (Hyrje, Sociologjia si një disiplinë shkencore; Imagjinata sociologjike; zhvillimi i të menduarit sociologjik; përse është me rëndësi të studiohet sociologjia?).	Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tirane 2005.
	Java – II	Metodologjia e kërkimit sociologjik (Zhvillimi i procesit të hulumtimit empirik; Metodatat e kërkimit; përdorimi i instrumenteve të vlerësimit dhe analizimi i të dhënave në programin SPSS).	Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tirane 2005.
	Java – III	Perspektivat dhe teoritë sociologjike (Cilat janë teoritë sociologjike? Rëndësia e përdorimit të perspektivave	Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tirane 2005.

		sociologjike në interpretimin e fenomeneve shoqërore).	
Java – IV		C'është shoqëria? (Tipet e shoqërisë; organizatat dhe grupet shoqërore; llojet e grupeve shoqërore; diversiteti shoqëror; tipet dhe format e organizatave; karakteristikat e burokracisë; zhvillimi i teknologjisë).	Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tirane 2005.
Java – V		Kultura dhe Identitetet (Simbolet, gjuha, vlerat shoqërore, normat, besimet, subkultura, multikulturalizimi, kontrakultura).	Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tirane 2005.
Java – VI		Socializimi (agjenset e socializimit: familja, grupmoshat, shkolla, masmediat; Roli i institucioneve në risocializimin e individëve).	Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tirane 2005.
Java – VII		TESTI 1	
Java – VIII		Klasat dhe stratifikimi shoqëror (sistemet e shtresëzimit shoqëror; teoritë shkencore për klasat dhe stratifikimi; mobilitetet shoqërore).	Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tirane 2005.
Java – IX		Krimi dhe sjelljet deviante (konceptet bazike; teoritë sociologjike në shpjegimin e krimit dhe sjelljeve deviante; krimi i organizuar; cyberkrimi; dënimi dhe burgjet).	Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tirane 2005.
Java – X		Institucionet shoqërore, familja dhe martesat (llojet e familjes; ndryshimet dhe problemet në jetën familjare: divorci; dhuna në familje; fëmijët jetim).	Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tirane 2005.
Java – XI		Pushteti, partitë politike dhe lëvizjet shoqërore (konceptet bazike për politikën, shtetin dhe pushtetin politik; globalizimi	Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tirane 2005.

		dhe lëvizjet shoqërore moderne).	
	Java – XII	TESTI 2	
	Java – XIII	Religjioni (funksionet e religjionit; tipet e organizatave religjioze; religjioni përgjatë historisë; religjioni në shoqëritë në ndryshim).	Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tirane 2005.
	Java – XIV	Raca, etniciteti dhe migrimi (C'është racizmi? Nga e vjetra tek forma e re e racizmit; konflikti, diversiteti dhe integrimi etnik; migrimi në botën bashkohore; diaspora globale).	Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tirane 2005.
	Java – XV	Masmediet (revolucionin digjital; interneti, filmi, televizioni, muzika dhe shtypi ditor; audience dhe opinioni publik; imperializimi medial; kontrolli politik i mediave).	Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tirane 2005.
ARRITSHMËRIA	<p>Qëllimi i kursit është t'i japë studentit një pasqyrë të qartë të strukturave sociale, metodat e studimit të shoqërisë, dilemat teorike, disa praktika të rëndësishme të komunikimit dhe ndikimit të medias.</p> <p>Andaj do të arrijnë këto rezultate:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët do të jenë në gjendje të aplikojnë konceptet themelore dhe format e analizës në Sociologji; - Studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë, përshkruajnë dhe shpjegojnë aspektet kryesore të funksionimit të marrëdhënieve shoqërore; - Të zhvillojnë të menduarit kritik lidhur me marrëdhëniet ndërmjet fenomeneve të ndryshme shoqërore; - Të aplikojnë një qasje multi-disiplinare në interpretimin e çështjeve të ndryshme që ndodhin në shoqëri; - Të njihen me metodologjinë empirike dhe të zhvillojnë shkathhtësitë në përdorimin e teknikave të kërkimit empirik. 		
LITERATURA	<ul style="list-style-type: none"> - Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tirane 2005. - John Macionis. Sociology. Botues PEARSON, Boston 2012. - Diana Kendall, Sociology in our times. Botues Princetson, New York, 2011. 		

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES	Do të përdoret metodologji interaktive e mësimdhënies. Puna në grupe të vogla për të zgjidhur çështje të ndryshme pastaj diskutim i hapur në klasë. Ofrimi i mundësisë për prezantime me qëllim të zhvillimit të shkathtësisë së komunikimit dhe thellimit të njohurive.
VLERËSIMI	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e rregulltë = 5 % - Aktiviteti në klasë = 5 % - Punimi i esesë = 15 % - TESTI 1 = 20 % - TESTI 2 = 20 % - Provimi përfundimtar = 35 %